



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT

AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

SHKOLLA E MESME TEKNOLOGJIKE "HYSEN ÇELA" Durrës

Nr. 329 Prot.

Durrës, më 14.08.2026

Lënda: Njoftim për vend vakant.

DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE

AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Rruga 'Bulevardi Bajram Curri', Tiranë

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 21, pika 2 e ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; të pikës 4, shkronja "a", të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 756, datë 9.12.2021, "Për sistemin e njohjes së të nxënit të mëparshëm joformal dhe informal", udhëzim Nr. 1109, datë 16.12.2024 për procedurat e vlerësimit dhe të certifikimit për zbatimin e sistemit të validimit të të nxënit të mëparshëm joformal dhe informal, neni 14, Ekspertët e validimit (profilet dhe kriteret) pika 7

Shkolla e mesme teknologjike "Hysen Çela", ju njofton krijimin e vendit të lire për pozicionin / pozicionet:

Specialist (keshillues) - 1 (një) vend vakant

A - Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

- Kritere të përgjithshme:** a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar; b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën; c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale; d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar; e) të

demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit; f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

2. Kritere të posacme për specialist (keshillues)

a) njohuri dhe përvojë të mjaftueshme në praktikat e këshillimit dhe orientimit, mundësisht për të rritur;u

b) njohuri për politikat publike dhe orientimet kryesore strategjike në fushën e arsimit dhe formimit për të rriturit/të nxënit gjatë gjithë jetës;

c) nivel të kënaqshëm njohurish për kuadrin ligjor të njohjes, si dhe për të drejtat dhe detyrat e kandidatëve, plus trajnimin fillestar;

ç) diplomë "Bachelor" – niveli 6 i KSHK-së në shkencat shoqërore, ose në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore ose fusha të ngjashme

B - Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë: a - letërmotivimin për pozicionin; b- jetëshkrimin (CV-në); c- kartën e identitetit; d- diplomën; e- librezën e punës; f- çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV; g- certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit; h- vërtetimin e gjendjes shëndetësore; i- vërtetimin e gjendjes gjyqësore; j- vërtetimin nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi; k - të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e Shkolles së Mesme Teknologjike "Hysen Çela", brenda datës ... 31.08.2026

3. Vlerësimi i kandidatëve do bëhet referuar përcaktimeve të udhëzimit nr.759, datë 30.09.2024, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit", i ndryshuar.

DREJTORE

Dr. Blerina DERVISHI

